Operatori i Sistemit të Transmetimit

Tiranë, më 19.05.2020

Lënda: Shtojcë për modifikim në dokumentet e tenderit

Objekti i Prokurimit: "Zgjerimi i monitorimit në Qendrën Emergjente të Kontrollit me N.St 110 kV të rehabilituara dhe komandimi i tyre nga NDC"

Mbështetur në Nenin 42, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe në Nenin 62, të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të porkurimit publik" i ndryshuar, Njësia e Prokurimit, pas pezullimit për shkak të Njoftimit datë 31.03.2020, të Agjencisë së Prokurimit Publik për periudhën e pandemisë "Covid-19", me iniciativën e saj, si dhe referuar sqarimit të Njoftimit Nr. 2371 Prot., datë 31.03.2020, të APP-së, bën ndryshimin e dokumenteve standarde të tenderit, për Procedurën e hapur - me mjete elektronike - Shërbime, me objekt "Zgjerimi i monitorimit në Qendrën Emergjente të Kontrollit me N.St 110 kV të rehabilituara dhe komandimi i tyre nga NDC", me fond limit 24,780,000 (njëzet e katër milion e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Modifikimi i dokumenteve të tenderit, bëhet në Shtojcën 8.2, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", Kapaciteti Teknik si më poshtë vijon:

ISHTE:

3.3.5 Operatori ekonomik ofertues për te bere te mundur kryerjen e këtij sherbimi duhet te provoje se ka ne stafin e tij kapacitetet teknike dhe profesionale, te pakten 1(një) inxhinier informatike dhe 2(dy) Inxhinier elektrik, keta te fundit duhet te jene te certifikuar dhe trajnuar nga prodhuesi i sistemit te kontrollit ne operim nga OST sha dhe RTU. Secili nga Inxhinieret elektrik duhet te jete i certifikuar si vijon:

Ne lidhe me skaden duhet te jetë i certifikuar(scada qendrore ose DCS- sistem kontrolli lokal) per:

- *Arkitekturen e sistemit te scades*
- *Bazat e scada*
- *Operimin ne scada*
- *Bazat inxhinierike te scada*

Lidhur me RTU duhet te jene te cerifikuar per:

- *Konfigurim dhe instalim te RTU-ve*
- *Njohje te komunikimit te protokolleve*

Inxhinieret e siperpermendur duhet te jene certifikuar dhe te jene pjese e stafit

te OE ofertues te pakten për 6 (gjashte) muajt e fundit

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues per te gjithe stafin e kerkuar me siper operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

i) listepagesat ku te konfirmohet qe jane punonjes te operatorit ekonomik te pakten per 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit;

ii) CV-të, diplomat dhe certifikatat qe vertetojne se punonjesi i disponon aftesite profesionale te tij ne perputhje me kerkesat e lartpermendura.

BËHET:

3.3.5 Operatori ekonomik ofertues për te bere te mundur kryerjen e këtij sherbimi duhet te provoje se ka ne stafin e tij kapacitetet teknike dhe profesionale, te pakten 1(një) inxhinier informatike dhe 2(dy) Inxhinier elektrik, keta te fundit duhet te jene te certifikuar dhe trajnuar për pajisjet RTU, si dhe për një nga sistemet e kontrollit në operim nga OST sh.a. Sistemi i kontrollit i referohet një sistemi qëndror kontrolli SCADA ose një sistemi lokal kontrolli (DCS). Secili nga Inxhinieret elektrik duhet te jete i certifikuar si vijon:

Ne lidhe me skaden duhet te jetë i certifikuar(scada qendrore ose DCS- sistem kontrolli lokal) per:

- *Arkitekturen e sistemit te scades*
- *Bazat e scada*
- *Operimin ne scada*
- *Bazat inxhinierike te scada*

Lidhur me RTU duhet te jene te cerifikuar per:

- *Konfigurim dhe instalim te RTU-ve*
- *Njohje te komunikimit te protokolleve*

Inxhinieret e siperpermendur duhet te jene certifikuar dhe te jene pjese e stafit te OE ofertues te pakten për 6 (gjashte) muajt e fundit

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues per te gjithe stafin e kerkuar me siper operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

iii) listepagesat ku te konfirmohet qe jane punonjes te operatorit ekonomik te pakten per 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit;

iv) CV-të, diplomat dhe certifikatat qe vertetojne se punonjesi i disponon aftesite profesionale te tij ne perputhje me kerkesat e lartpermendura.

Shtohen Kriteret:

3.3.6 *Operatori Ekonomikofertues duhet te paraqese autorizimin e prodhuesi / distributorit te autorizuar per mallrat:*

Kartë komunikimi dhe procesimi.

Liçensa (Flash) për kartë komunikimi & proçesimi.

Autorizimi duhet te përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail,

website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

3.3.7 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqese katalogun e prodhuesit për mallrat objekt prokurimi për të cilat është kërkuar Autorizimi i prodhuesit/distributorit të autorizuar, pjesë që i përkasin të dhënave teknike, të jetë përkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar.*

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje / Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje shtyhet nga data **03.04.2020**, **ora 10:00**, në datë **26.05.2020, ora 10:00.**